

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.11.2024*

21.11.2024

Ora, 10:41

**RENDI I DITËS**

**Shorti “Për caktimin e kërkesave ankimore nr.24, 25, 26 dhe 27”.**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ:** **Znj. M. Çelmeta , z. E. Mema**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **S’ka**

**Znj. M. Çelmeta:** Përshëndetje, sot me datë 21 nëntor 2024 do të zhvillohet procedura të hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për katër kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr. 24, me ankues “Aleanca Progresiste e Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”. Kërkesa ankimore nr. 25, me ankues “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”. Kërkesa ankimore nr.26 me ankues “Aleanca Demokratike” dhe kërkesën ankimore nr. 27 me ankues Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Mëlyshi. Kanë si objekt kundërshtimin e vendimit nr.186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në katër prej tyre janë shënuar kërkesat ankimore dhe një shirit letre është i bardhë dhe pa shënime të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Fillojmë me futjen e shiritave në gogël, duke qenë se anëtarët e KAS-

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 21.11.2024*

it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre, për përcaktimin e relatorit.

**(Hidhet shorti)**

Pasi përziejme goglat vazhdojmë me rendin alfabetik, duke filluar nga:

1. z. Elvin Lako
2. z. Elvis Çefa
3. z. Ilirjan Rusmali
4. Z. Koli Bele
5. Z. Ledio Braho

Hapim goglën e parë, është kërkesa ankimore nr. 24, përziejme. Hapim goglën e dytë, është kërkesa nr. 27. Hapim goglën e tretë, shiriti është i bardhë, pa asnjë shënim. Hapim goglën e katërt, shiriti përmban kërkesën ankimore nr. 26 dhe goglën e fundit, shiriti përmban kërkesë ankimore nr. 25. Atëherë në përfundim të procedurës së shortit relator për kërkesën ankimore nr. 24 është z. Elvin Lako. Relator për kërkesën nr. 25 është z. Ledio Braho. Relator për kërkesën nr. 26 është z. Koli Bele dhe relator për kërkesën ankimore nr. 27 është z. Elvis Çefa.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

